



Pranuar / Dorezuar Prinjenca/Prodato Received/Delivery	23-06	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDM8HCK	3675/2022		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.431/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Valentina Kaçandolli - Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.431/2022 të datës 28.04.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike-administrative "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.431/2022 e datës 28.04.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.Prot.05-1840 i datës 15.04.2022 i Sekretari të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmarr veprimet e duhura procedurale për kompensimin e ankueses si në piken 1 të këtij vendimi, për angazhimin dhe punën jashtë orarit të rregullt si sekretare teknike në Bordin Qendror për Shkollim Specialistik.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy e t i m

Ankuesja [REDACTED] e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, në pozitën e punës “Asistente Administrative”, me datën 28.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.Prot.05/1840 të datës 15.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin vendim ankueses i është refuzuar kërkesa për kompensimin e orëve të punës jashtë orarit të rregullt të punës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 28.04.2022 me numër protokoli 2478/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin VK.nr.52/2022 të datës 08.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.Prot.05-1840 të datës 15.04.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin me numër A.nr.97/2022 të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 19.04.2022 lidhur me njoftimin për zbatimin e vendimit të Këshillit nga Ministria e Shëndetësisë; Vendimin VK.nr.20/2022 të datës 21.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbalin e datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 07.02.2022 me numër protokoli 570/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 12.11.2021 për ekzekutim të pagesave nga ankuesja; Kërkesën e datës 05.10.2020 për aprovim të komisionit për intervistimin e kandidatëve për shkollim specialistik gusht-shtator 2020; Lista me pagesat e komisionit për intervistimin e kandidatëve për shkollim specialistik gusht-shtator 2020; Kërkesën e datës 05.11.2020 për zbatim të vendimit me numër 05-6300 të datës 05.10.2020; Procesverbalin e datës 01.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 01.09.2020 nga komisioni intervistues për kandidatët që kanë aplikuar për specializim; Procesverbalin e datës 02.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 03.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 04.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 07.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 08.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 09.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 10.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 11.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 14.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 15.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 16.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 17.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 18.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 21.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 22.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 23.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 24.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për

specializim; Procesverbalin e datës 25.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 28.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 29.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 30.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 24.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 25.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 26.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 27.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 28.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Procesverbalin e datës 31.08.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Listën e kandidateve dhe kohen për intervista të konkursit të datës 30.07.2020; Kërkesën e datës 04.12.2020 mbi aprovimin e punës gjatë ditëve të vikendit për regjistrimin e pikëve në sistemin elektronik për kandidatët që kanë fituar specializimin; E-mailin zyrtar të datës 05.03.2021; E-mailin zyrtar të datës 21.09.2020; E-mailin zyrtar të datës 21.09.2020; E-mailin zyrtar të datës 16.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 18.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 15.01.2021; Vendimin me numër Nr.05/1/2021 të datës 12.01.2021; Dëshmi lidhur me komisionin për korrigjimin e listave për pagesën e specializantëve me subvencionim të datës 15.01.2021; Dëshmi lidhur me komisionin për korrigjimin e listave për pagesën e specializantëve me subvencionim të datës 17.01.2021; Dëshmi lidhur me komisionin për korrigjimin e listave për pagesën e specializantëve me subvencionim të datës 16.01.2021; Procesverbalin e datës 19.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; Dëshmi lidhur me përgatitjen dhe shtypjen e lëndëve për intervistim të datës 26.09.2020; Procesverbalin e datës 26.09.2020 lidhur me intervistimin e kandidatëve për specializim; E-mailin zyrtar të datës 16.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 06.11.2020; E-mailin zyrtar të datës 23.10.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë fituar specializimin të datës 08.11.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë fituar specializimin të datës 07.11.2020; E-mailin zyrtar të datës 21.11.2020; Dëshmi mbi mbledhjen e Komisionit për Ankesa të shkallës së dytë të datës 21.11.2020; Mbledhjen e Komisionit të Ankesave të shkallës së dytë të datës 20.11.2020; Mbledhjen e Komisionit të Ankesave të shkallës së dytë të datës 21.11.2020; Mbledhjen e Komisionit të Ankesave të shkallës së dytë të datës 22.11.2020; E-mailin zyrtar të datës 23.10.2020; Dëshmi lidhur me regjistrimin e pikëve në sistem të kandidatëve që janë pranuar për specializim të datës 24.10.2022; Dëshmi lidhur me regjistrimin e pikëve në sistem të kandidatëve që janë pranuar për specializim të datës 25.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 15.11.2020; E-mailin zyrtar të datës 06.11.2020; E-mailin zyrtar të datës 23.10.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët të datës 15.11.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen e kontratave dhe vendimeve për kandidatët që kanë fituar specializimin të datës 14.11.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen dhe shtypjen e lëndëve për intervistim të datës 18.10.2020; Dëshmi lidhur me përgatitjen dhe shtypjen e lëndëve për intervistim të datës 17.10.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 28.02.2022 nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankueses me numër Nr.076 të datës 10.02.2012; Vendimin me numër Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020

mbi themelimin e Bordit Qendror për shkollim specialistik; Listën e pagave për muajin tetor dhe dhjetor të vitit 2020; Raportin e prezencës në punë për periudhën 01.08.2020-28.02.2021 për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht Akt Emërimin me numër Nr.076 të datës 10.02.2012 ka konstatuar se ankuesja [redacted] është në marrëdhënie të punës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe se e njëjta mban pozitën e punës *Asistente administrative*, në Departamentin e Menaxhimit Strategjik. Kolegji i Këshillit po ashtu nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë me Vendimin Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020 ka themeluar Bordin Qendror për Shkollim Specialistik, përgjegjës për intervistimin e kandidateve për specializim, ku ankuesja sipas këtij vendimi ka qenë e caktuar në cilësinë e sekretarisë teknike.

Ankuesja me datë 12.11.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 05-7285 të Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës, për periudhën sa ka qenë e caktuar në cilësinë e sekretarisë teknike në Komisionin intervistues sipas Vendimit me numër Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 12.11.2021 përmes e-mailit zyrtar ka obliguar zyrtarin përgjegjës të njësisë për burime njerëzore që të adresoj kërkesën me numër protokoll 05-7285 të datës 12.11.2021 në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Njësia për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë nuk e ka adresuar dhe rrjedhimisht shqyrtuar kërkesën me numër protokoll 05-7285 të datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesja, respektivisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës sipas urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me Vendimin A.nr.97/2022 të datës 06.04.2022 kishte konstatuar se zyrtari përgjegjës i Njësies për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë me rastin e mos adresimit dhe rrjedhimisht mos shqyrtimit të kërkesës sipas urdhrit të Sekretarit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit*, dhe rrjedhimisht ka detyruar organin e punësimit që të shqyrtojë kërkesën e datës 12.11.2021 të parashtruar nga ankuesja në drejtim të realizimit të pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës, për periudhën sa ka qenë e caktuar në cilësinë e sekretarisë teknike në Komisionin intervistues sipas Vendimit me numër Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020.

Organi i punësimit, gjegjësisht Zyrtari Kryesor Administrativ në Ministrinë e Shëndetësisë, me Vendimin me numër protokoll Nr.Prot.05-1840 të datës 15.04.2022 ka refuzuar kërkesën e ankueses për kompensimin e pagesës për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës me arsyetimin se nuk janë respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet tjera të Nëpunësve Civil.

Ankuesja, me datë 28.04.2022, me pretendime të njëjta ankimore ka parashtruar ankesë edhe ndaj Vendimit me numër protokoll Nr.Prot.05-1840 të datës 15.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civile kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës, ..., po ashtu me nenin 21 të këtij ligji është paraparë kompensimi me pagesë ose me kohe të lirë për punë jashtë orarit.*

Andaj, duke marr parasysh se ankuesja sipas Vendimit Nr.600/VII/2020 të datës 07.07.2020 për themelimin e Bordit Qendror për Shkollim Specialistik, përgjegjës për intervistimin e kandidateve për specializim, ka qenë e caktuar në cilësinë e sekretarisë teknike, dhe rrjedhimisht e njëjta si dëshmi për angazhim e saj jashtë orarit të rregullt të punës ka sjellë procesverbalin e nënshkruar për secilin takim të Bordit, duke përfshi edhe kohën e angazhimit të saj, e të cilat dëshmi nuk janë kontestuar as nga organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se e njëjta duhet të kompensohet për angazhimin e saj jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, sepse kërkesa e saj në para nuk është parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës.

Kolegji i Këshillit, po ashtu duke ju referuar shkresave të lëndës ka gjetur se anëtarët tjerë të Bordit Qendror për Shkollim Specialistik, për angazhimin e tyre në komisionin përkatës në procesin e intervistimit të kandidateve për specializim, janë kompensuar, andaj konstaton se organi i punësimit edhe ndaj ankueses duhet të veproje njëjtë në respektim të dispozitave të nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 1 paragrafi 1 dhe nenin 3 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.


Andaj bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Udhëheqësi Kryesor Administrativ, në këtë rast, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për kompensimin e ankueses, për angazhimin dhe punën jashtë orarit të rregullt, si sekretare teknike në Komisionin Qendror për Shkollim Specialistik, bazuar në dëshmitë e siguruara nga kryesuesi i komisionit përkatës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.431/2022.

Valentina Kaçandolli - Bekteshi  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

